

Zyra e Burimeve Njerëzore

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune të R. Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë nr. 62/2005), Universiteti i Evropës Juglindore – Tetovë shpall :

K O N K U R S

Për plotësimin e vendit të punës me kohë të caktuar deri më 31.08.2014

Këshilltarë Studentor në Fakultetin e Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit

Qëllimi primar i pozitës: Të punojë me prodekanin për studime deridiplomike dhe me anëtarët tjerë të zyrës të Dekanit, të këshillojë studentët për kërkesat e programit dhe planifikimin e karrierës, të kontrollojë dosjet e studentëve për progresin e arritur kundrejt kërkesave të programit dhe të merr pjesë në aktivitetet administrative për studentët, si që janë orientimi dhe përkrahja.

Përveç kushteve të përgjithshme të parapara me Ligji, kandidati duhet t'i plotësoje edhe kushtet që vijnë:

Themelore:

- Diplomë universitare ose kualifikim ekuivalent;
- Dy vjet përvojë në administratë në lidhje me shërbimet e klientit;

Preferohet:

- Njohuri lidhur me dhënien e këshillave për karrierë
- Përvojë në arsimimin e lartë;
- Kualifikim administrativ ose të ngjashme;

Kandidati duhet të posedojë shkathtësi dhe aftësi:

Themelore:

- Komunikim efektiv (gojor dhe të shkruar) në tri gjuhët zyrtare që përdoren në nivel të Universitetit (shqip, maqedonisht dhe anglisht) dhe kontribut në implementimin e Politikës gjuhësore;
- Shkathtësi komunikimi efektiv ndër-personal;
- Aftësi funksionimi me maturi;
- Aftësi për të punuar në ekip;
- Aftësi për të siguruar informata dhe të dhëna të qarta dhe të sakta ashtu siç kërkohet;
- Aftësi për të bashkëpunuar në mënyrë pozitive dhe aktive me një numër të madh studentësh dhe me anëtarë të staf të niveleve të ndryshme;
- Shkathtësi të mira organizative dhe mundësi për të kryer detyra të ndryshme;
- Aftësi për të punuar në mënyrë fleksibile, për të bashkëpunuar dhe punuar në mënyrë të pavarur;

- Aftësi për të caktuar në mënyrë efektive prioritetet në punë dhe respektim i kohë dhe afateve të parapara;
- Prezencë dhe përpikëri të shkëlqyeshme dhe shfrytëzim efektiv të orarit të punës;
- Aftësi për të përdorur teknologjitë e informacionit dhe sistemin kompjuterik të Universitetit me qëllim të plotësimit të kërkesave të punës;
- Gatishmëri për të ndjekur trajnime;
- Gatishmëri për punë, kontribut dhe promovim të misionit e Universitetit për përsosmëri dhe barazi;

Preferohen:

- Aftësi për të dhënë sugjerime lidhur me zgjidhjen e problemeve dhe plasimin e ideve të reja lidhur me vendin e punës;
- Aftësi dhe dëshirë për të udhëtuar kur është e nevojshme;

Fillimi dhe përfundimi i kohës ditore dhe javore të punës: **Nga ora 08,00 deri 16,00, nga e hëna deri të premten.**

Paga bazë: **450 € (27.675 MKD)**

Afati i dorëzimit të aplikacioneve është **5** ditë nga dita e shpalljes së konkursit.

Konkursi është i shpallur nga 27.05.2014 deri më 31.05.2014

Ju lutemi e dërgoni aplikimin për punësim nëpërmjet e-mailit: jobs@seeu.edu.mk (**Aplikacion valid do konsiderohet vetëm aplikacioni i plotësuar që gjendet në ueb faqen e Universitetit, në rubrikën Konkurse. Çdo lloj tjetër forme aplikacioni nuk do merret parasysh.**)

Adresa

Universiteti i Evropës Juglindore

Zyra e Burimeve Njerëzore

Bul. "Ilinden" nr. 335

1200 Tetovë, Maqedoni

Telefoni për kontakt: 044 356 087